



# **RAPORT PËRMBLEDHËS**

## **Janar – Dhjetor**

### **2024**

**Mbi veprimtarinë e Qendrës së Koordinimit kundër  
Ekstremizmit të Dhunshëm**

## **PËRMBLEDHJE E MATRICËS SË REALIZIMIT TË PRIORITETEVE PËR VITIN 2024**

Ky raport ka për qëllim të përmbledhë aktivitetin vjetor 2024 të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe është hartuar duke evidentuar aktivitetet e kryera bazuar në detyrimet që rrjedhin nga VKM nr.737/2017 “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, i ndryshuar, VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku”, VKM nr. 81, datë 14.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023 – 2025” dhe të planeve të veprimit 2023-2025”.

### **1. FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËR TË IDENTIFIKUAR DHE RAPORTUAR RASTET E EKSTREMIZIMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT**

QKEDH-ja ka vijuar angazhimin e saj në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025 dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj. Gjatë 2024 QKEDH-ja është angazhuar në zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe jo shtetërorë të përfshirë në masat kundër ekstremizmit të dhunshëm, me fokus në:

- Forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit mes institucioneve ligjzbatuese për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe me partnerë të huaj në nivel vendor (rajonale dhe ndërkombëtar);
- Komunikimin e vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve mes institucioneve dhe strukturave të përfshira me qëllim krijimin e mekanizmave për ndërgjegjësimin mbi rrezikun ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm;
- Ngritjen e kapaciteteve të institucioneve publike në raport me ekstremizmin e dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm. Për këtë është dhënë kontribut i rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve të punonjësve të policisë së shtetit, të administratës së burgjeve dhe shërbimit të provës, përmes trajnimeve të orientuara në identifikimin e shenjave të hershme të radikalizmit dhe adresimin e tyre në institucionet përgjegjëse.
- Ngritjen e kapaciteteve të institucioneve publike për proceset e rehabilitimit dhe riintegritimit të personave të radikalizuar ose të kthyerit nga zonat e konfliktit;
- Fuqizimin ekonomik të personave të radikalizuar dhe familjeve të kthyer nga vendet e konfliktit përmes integritimit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim.

Me qëllim sinjalizimin e hershëm dhe parandalimin, QKEDH-ja është investuar në forcimin dhe efikasitetin e funksionimit (*përmes takimeve dhe trajnimeve*) të Komiteteve Rajonale kundër ekstremizmit të dhunshëm të ngritura me Urdhër të KM nr. 185/2023 si mekanizëm kombëtar për referimin e rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Lidhur me Komitetet Rajonale është evidentuar një çështje për adresim referuar raportimit mujor të anëtarëve ndaj Prefektit, i cili kryeson Komitetin Rajonal. Për të mundësuar raportimin mujor të anëtarëve sipas Urdhrit të KM nr. 185/2023 nga të gjithë anëtarët dhe shkëmbimin e informacionit duhen kryer përpjekje për të garantuar grumbullim sa më të plotë të informacionit të nevojshëm në përputhje me ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

QKEDH-ja për sa më sipër është mbështetur në bashkëpunimin me ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2023-2025, si dhe me organizatat e shoqërisë civile që zhvillojnë aktivitetet në këtë fushë.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, QKEDH-ja ka vlerësuar dhe përcjellë pranë zyrave kompetente në Ministrinë e Brendshme, nevojën për organizimin e një takimi me donatorë në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale ndërsektoriale, përfshirë për të gjitha nismat e procesit të riintegritit të shtetasve të kthyer, apo në rrezik radikalizmi në shoqërinë shqiptare.

## **2. PROCESI I REHABILITIMIT/ RIINTEGRIMIT/ RISOCIALIZIMIT PËR PERSONAT E KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT SIRI/IRAK (RRR)**

Ka vijuar puna falë mbështetjes së donatorëve dhe veçanërisht Fondit Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit (GCERF) që kanë mbështetur proceset e Rehabilitimit, Riintegritit dhe Risocializimit (RRR).

Gjatë vitit 2024, procesi i Rehabilitimit, Riintegritit dhe Risocializimit (RRR) për personat e kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak ka përfshirë një sërë aktivitetesh të rëndësishme për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen e personave të kthyer me anë të shërbimeve shtetërore. Janë realizuar sesione informuese për ngritjen e kapaciteteve të Grupeve Teknike Ndërsektoriale në pesë bashki kryesore (Shkodër, Kamëz, Cërrik, Krujë dhe Tiranë) të koordinuara nga QKEDH-ja.

Në aspektin e monitorimit dhe vlerësimit, QKEDH-ja ka kryer një punë intensive në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Gjatë vitit janë prodhuar raporte lidhur me shërbimet e riintegritit ndaj shtetasve të kthyer të këshillimit psikologjik, të edukimit mbështetës, të planit arsimor, të teologëve dhe të zbatimit të Planeve Individuale të Mbrojtjes. Është në proces miratimi Procedura Standarde e Veprimit (PSV) për rehabilitimin dhe riintegritin e personave të kthyer, në përputhje me objektivat e planit të veprimit.

Gjatë vitit janë realizuar tre vlerësime kombëtare mbi Ekstremizmin e Dhunshëm, "Vlerësimi i nevojave të vendit për të indentifikuar nevojat kryesore për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, Riatdhesimin dhe Rehabilitimin në Shqipëri" nga PVN Albania me mbështetjen e GCERF-it, dhe "Vlerësimi i Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri për vitin 2024" nga IDM-ja me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, “Raport Monitorimi – përhapja e gjuhës së urrejtjes dhe narratives ekstremiste në hapësirën digjitale” nga Akademia e Studimeve Politike me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara dhe AKCESK.

Një komponent i rëndësishëm i procesit RRR ka qenë fuqizimi ekonomik dhe social i personave të kthyer përmes workshopeve praktike në fusha të ndryshme profesionale, përfshirë zejtarinë.

Gjithashtu përgjatë periudhës raportuese, QKEDH-ja ka ruajtur një prezencë aktive në nivel ndërkombëtar duke marrë pjesë në konferenca dhe takime rajonale/ndërkombëtare, si dhe në aktivitete në nivel kombëtar, duke përfshirë pjesëmarrjen në rrjetin RAN (Radicalization Awareness Network).

Rëndësi paraqet fuqizimi i aktorëve të nivelit vendor. QKEDH-ja ka ndërmjetësuar që bashkitë të arrijnë të gjejnë zgjidhjet e duhura në nivel vendor, duke përfshirë integrimin e funksioneve parandaluese (identifikimi i rasteve) dhe të menaxhimit të rasteve në rrezik radikalizmi nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësit socialë të Bashkisë Tiranë.

### **3. HARTIMI I POLITIKAVE GJITHËPËRFSHIRËSE AFATGJATA KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

Aktivizimi i plotë i Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm ka qenë arritje e rëndësishme, me realizimin e takimeve në të 12 qarqet e vendit, në vitin e parë të funksionimit. Në këtë kuadër, QKEDH-ja përmes Koordinatorit Kombëtar Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka zhvilluar sesione informuese për anëtarët dhe Sekretariatet Teknike të Komiteteve Rajonale në Elbasan, Fier dhe Berat, duke u fokusuar në adresimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe përgjigjen ndaj nevojave të të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Zhvillim i rëndësishëm ka qenë forcimi i rolit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP) në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. QKEDH-ja ka organizuar tryeza të rumbullakëta në bashkitë Pogradec, Korçë, Elbasan, Librazhd dhe Cërrik, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve vendorë.

Në fushën e edukimit dhe ndërgjegjësimit, QKEDH-ja ka zhvilluar një sërë iniciativash informuese të rëndësishme në shkollat 9 vjeçare në pesë bashki (Vlorë, Fier, Kavajë, Cërrik, Pogradec) me pjesëmarrjen e 260 të rinjve të moshës 13-18 vjeç. Përgjatë periudhës raportuese është kryer rivitalizimi i rrjetit të mësuesve koordinatorë kundër ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë përditësimin e bazës së të dhënave për 1,137 mësues dhe zhvillimin e trajnimeve specifike. Gjithashtu, janë trajnuar dhe certifikuar 220 oficerë të sigurisë në shkolla në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në përputhje me paketën e Sigurisë në Shkolla. Në nivel komuniteti, janë realizuar nisma të drejtuara nga rinia dhe takime për forcimin e qëndrueshmërisë së komunitetit, ku janë përfshirë institucione të ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile, komuniteteve fetare, institucioneve arsimore, prindër dhe të rinj.

### **4. RAPORTIMI I AKTIVITETEVE PËR PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE**

QKEDH-ja ka pasur bashkëpunime si dhe jep kontributin e saj periodik në lidhje me kapitullin 24 “Liria, Drejtësia dhe Siguria” si dhe për Kapitullin 31 “Politika e Jashtme e Sigurisë dhe e Mbrojtjes”, në lidhje me procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin

Evropian. Gjithashtu, ka koordinuar me të gjitha institucionet takimet e grupit të Misionit të BE-së, TAIEX si dhe takimet për monitorimin e Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor 2024. Në përmbushje të qëllimit të saj, QKEDH-ja jep kontribut sa herë që kërkohet apo ka nevojë misioni shqiptar në OKB në lidhje me procesin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe proceset RRR.

## 5. PËRFUNDIME

Vlerësimi i kapaciteteve institucionale të QKEDH-së gjatë vitit 2024 ka nxjerrë në pah nevojën për fuqizim në tre drejtime kryesore:

1. Kërkesën për shtesën e organikës për të përballuar volumin në rritje të procesit të punës;
2. Rritjen e fondeve për zbatimin e programeve, dhe
3. Modernizimin e infrastrukturës teknologjike përmes rinovimit të proceseve digjitale.


Këto nevoja reflektojnë domosdoshmërinë e forcimit të kapaciteteve të institucionit për të përmbushur objektivat afatgjata. Pavarësisht se mbështetja e donatorëve është garantuar deri në dhjetor 2025, planifikimi strategjik për periudhën pas vitit 2025 kërkon një qasje të re gjithëpërfshirëse. Strategjia e re ndërsektoriale dhe Plani i ri i Veprimit potencialisht për periudhën 2026-2030 dhe Plani i Përbashkët i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor (për rinovim) kërkon së pari, rritjen e ndërgjegjësimit të donatorëve për rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimeve ndaj të kthyerve dhe zbatimin e masave në kontestin e Burgjeve dhe Shërbimit të Provës; dhe së dyti, sigurimin e angazhimit të tyre konkret për mbështetje buxhetore afatgjatë për të gjitha masat. QKEDH-ja do të vazhdojë të angazhohet në pesëvjeçarin e ardhshëm për të rritur ndërgjegjësimin institucional dhe të donatorëve lidhur me nevojat e rasteve në trajtim.

Një sfidë që kërkon vëmendje të menjëhershme është garantimi i qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve në nivel qendror dhe lokal. Duke pasur parasysh se grupi i individëve në rrezik përfshin të mitur dhe adoleshentë, është thelbësore të sigurohet një trajtim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për 5-10 vitet e ardhshme. Ky trajtim duhet të integrojë në mënyrë harmonike komponentët arsimor, psikosocial dhe shëndetësor, duke krijuar një sistem mbështetës të qëndrueshëm që siguron zhvillimin e shëndetshëm dhe integrimin e plotë të këtyre individëve në shoqëri. Kjo qasje kërkon jo vetëm angazhim institucional, por edhe një koordinim të përmirësuar ndërsektorial dhe një plan buxhetor që garanton vazhdimësinë e këtyre shërbimeve thelbësore.

Në kuadër të planifikimit strategjik, QKEDH-ja synon të propozojë ngritjen e një grupi ndërinstucional pune gjatë vitit 2025, me qëllim hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2026-2030. Në vijim të këtij procesi, parashikohet që strategjia të shoqërohet nga dy dokumente thelbësore: "Plani i Veprimit për luftën kundër terrorizmit" dhe "Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm".

## Aktivite trajnuese/informuese/ndërgjegjësuere

\*Shifrat e grafikut shprehin numrin total të pjesëmarrësve të aktiviteteve të ndryshme



- Trajnime për oficerë të patrullës së përgjithshme për të rritur ndërgjegjësimin për ekstremizmin e dhunshëm dhe shenjat e hershme të radikalizmit me fokus të rinjtë (98 pjesëmarrës)
- Trajnimi i oficerëve të policisë kufitare për tendencat e radikalizmit, metodat e rekrutimit, radikalizmin dhe mekanizmat e referimit të problemeve (50 pjesëmarrës)
- Trajnimi i oficerëve të policisë në komunitet për tendencat e radikalizmit, metodat e rekrutimit, radikalizmi (101 pjesëmarrës)
- Trajnime me stafin e burgjeve dhe shërbimit të provës (173 pjesëmarrës)
- Seanca Këshillimi në grup me individë të burgosur dhe individë të përfshirë në institucionet vendore të shërbimit të provës (74 pjesëmarrës)
- Trajnime për shëndetin mendor dhe fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm (në lidhje me shkaqet dhe pasojat si dhe shëndetin mendor në lidhje me këtë fenomen) (153 pjesëmarrës)
- Trajnimit/Sesione Ndërgjegjësuere për Oficerët e Sigurisë dhe ofruesve të shërbimeve sociale në shkolla mbi çështjet e krimit kibernetik, parandalimit dhe trajtimin e tij si edhe gjuhën e urrejtjes me bazë fetare dhe racore (220 pjesëmarrës)
- Trajnim për aktorë të vijës së parë mbi procesin RRR (në rast procesi të V-të riatdhesimit) (484 pjesëmarrës)
- Workshope me të rikthyerat për modelet pozitive dhe histori të suksesit (91 pjesëmarrës)
- Konferenca/ aktivitete/ takime/ forume etj., në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (64 pjesëmarrës)
- Takime të Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (247 pjesëmarrës)
- Trajnime të specializuara për Komitetet Rajonale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (50 pjesëmarrës)
- Tryeza të rrumbullakëta për KVSP (155 pjesëmarrës)
- Trajnime me psikologë, mësues, punonjës social, drejtorë shkolle, oficerë sigurie në shkolla, nxënës (në linjë edhe me strategjinë e sigurisë në komunitetet dhe paketën e sigurisë në shkolla, të miratuar nga MB) (360 pjesëmarrës)
- Dialog me komunitetin. Së bashku për një komunitet më të qëndrueshëm ndaj ekstremizmit të dhunshëm (514 pjesëmarrës)
- Trajnim i mësuesve koordinatorë kundër ekstremizmit të dhunshëm (20 pjesëmarrës)